



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 5 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 9 dhe 10 të Rregullës Zgjedhore nr. 09/2009 “Votimi dhe Numërimi brenda Vendvotimeve”, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 10.11.2010 miratoi këtë:

UDHËZIM për strukturat zgjedhore për pranimin e dokumenteve për votim në vendvotim

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Udhëzon strukturat e veta zgjedhore që merren me organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve, që ditën e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës me 12 dhjetor 2010 të pranoj dokumentet e Identifikimit të votuesve në vendvotim siç janë përcaktuar në nenin 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
- II. Votuesi që ditën e zgjedhjeve posedon ndonjërin nga dokumentet e parapara në nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të votojë pavarësisht skadimit të afatit të tyre.
- III. Ky Udhëzim është i obligueshëm për të gjithë strukturat zgjedhore të KQZ/SKQZ-së në territorin e Republikës së Kosovës, dhe zbatohet Ditën e Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës me 12 dhjetor 2010.
- IV. Ky Udhëzim hyn në fuqi me 10.11.2010 dhe iu dërgohet strukturave zgjedhore menjëherë.

Prishtinë më, 10.11.2010

Valdete Daka

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
